



Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština – Assembly

Legjislatura IV

Komisioni për Buxhet dhe Financa

Mbledhja nr. 04/11

Prishtinë, më 28.03.2011, ora 11:00

Ndërtesa e Kuvendit, salla C-203

PROCESVERBAL
I MBLEDHJES SË KOMISIONIT PËR BUXHET DHE FINANCA

Në mbledhje morën pjesë: Safete Hadërgjonaj, Naser Osmani, Jelena Bontić, Latif Gashi, Hasime Krasniqi, Hykmete Bajrami, Sali Asllanaj, Xhevdet Neziraj, Muhamet Mustafa dhe Duda Balje.

Mungoi: Albana Fetoshi.

Gjithashtu të pranishëm ishin edhe Bedri Hamza-Ministër i Financave, Agim Krasniqi- Drejtor i Buxhetit të Përgjithshëm, Alexander Beetz, Juergen Schatz, Ramadan Islami, Teki Shala dhe Njomza Ilazi nga GIZ si dhe monitorues Zyra e Presidentit, nga KDI dhe USAID.

Nga stafi mbështetës i komisionit: Vilson Ukaj, Sabrije Saliuki – Iseini, Dashurije Canolli dhe Aurora Ademi (praktikante).

Mbledhjen e kryesoi Safete Hadërgjonaj, Kryetare e Komisionit.

Për këtë mbledhje propozohet ky rend dite:

- 1. Miratimi i rendit të ditës;**
- 2. Shqyrtimi i Projektligjit (pjesa tekstuale) të Buxhetit të Republikës së Kosovës për vitin 2011;**
- 3. Shqyrtimi i rekomandimeve të komisioneve parlamentare lidhur me Projektligjin e Buxhetit të Republikës së Kosovës për vitin 2011:**
 - 3.1. Shqyrtimi i rekomandimit të Komisionit për Mbikëqyerjen e Financave Publike,**
 - 3.2. Shqyrtimi i rekomandimit të Komisionit për Punë të Jashtme,**
 - 3.3. Shqyrtimi i rekomandimit të Komisionit për Bujqësi, Pylltari, Zhvillim Rural, Mjedis dhe Planifikim Hapësinor,**
 - 3.4. Shqyrtimi i rekomandimit të Komisionit për Shëndetësi, Punë dhe Mirëqenie Sociale;**
- 4. Shqyrtimi i kërkesave buxhetore lidhur me Projektligjin e Buxhetit të Republikës së Kosovës për vitin 2011;**
- 5. Të ndryshme.**

1. Miratimi i rendit të ditës

Kryetarja, hapi mbledhjen dhe propozoi rendin e ditës. Rendi i ditës miratohet pa ndryshime.

2. Shqyrtimi i Projektligjit (pjesa tekstuale) për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2011

Kryetarja, propozoi që neni 4 të lëmë për nesër për shqyrtim, ku Qeveria ka njoftuar se do të dal me një propozim të ri, për riformulimin e tij.

Meqë që përkufizimi 1.17 dhe 1.21, është i ngjajshëm me përkufizimin 1.1, që kanë të bëjnë me përkufizimin për Buxhetin e Republikës së Kosovës, u propozua të fshihen. Propozimi u përkrah njëzëri.

Të gjithë anëtarët e pranishëm u pajtuan që ë tërë tekstin e projektligjit ku përmendet "Ministria e Ekonomisë dhe Financave apo Ministri i Ekonomisë dhe Financave", të zëvendësohen me shprehjet "Ministria e Financave apo Ministri i Financave". Si dhe të bëhen ndryshimet teknike në përkufizimet që kanë dalur si rezultat i ndryshimit të legjislacionit.

Naser Osmani, mundet me mbet çështja e konsultimet me Përfaqësuesin Civil Ndërkombëtar (PCN) , pasi që nuk kemi të bëjmë me vendimmarrje.

Kryetarja, njoftoi se zonat kadastrale dhe çështjet e komunave të reja, janë të rregulluara me ligjin për kufijtë administrativ.

Agim Krasniqi, duke u ndërlidhur me çështjen, informoi anëtarët se në periudhën e tranzicionit deri në krijimin e komunave të reja, që është periudha prej krijimit deri të certifikimi i zyrtarëve administrativ, nevojitet konsultimi dhe ndihma nga Ministria e Pushtetit Lokal dhe PCN, që është një ndihmë edhe në procesin financiar.

Muhamet Mustafa, teksti flet për komunat ekzistuese dhe jo për ato në themelimin e sipër. Kërkoj një sqarim për nenin 5.2. që është paraparë në tekstin e projektligjit. Kush është përgjegjës për mjetet që po ndahen. Nëse është fjala për komunat përgatitore duhet riformuluar paragrafin. Përndryshe nëse ne ndajmë mjete, duhet ditur se kujt po i ndajmë, për të kërkuar llogari si janë shpenzuar ato.

Bedri Hamza, njoftoi se pritet të themelohen komunat e reja dhe mjetet janë brenda tabelave buxhetore, që duhet shpërndarë këtyre komunave sapo të konsolidohen organet e administratës. Në këtë drejtim është e nevojshme konsultimi me Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal dhe Zyrën e PCN, që ka rolin e vet në procesin e privatizimit.

Latif Gashi, theksoi se nuk do të duhej të mbetet konsultimi me PCN, sepse në këtë formë ai po bëhet faktor në procesin vendimmarrës së buxhetit.

Sali Asllanaj, përkrahu rregullimin që është bërë në projektligj, që parasheh kufizimin e shtimit të numrit të puntërove gjatë viti fiskal dhe kjo është në funksion të disiplinimit në organizatave buxhetore dhe e kufizon kërkesën për rritjen e numrit të shërbyesve civil. Sa i përket nenit që rregullon paradhënien, shfaq mendimin që paradhënia të jetë 20%, që është në funksion të ndihmesës së kompanive.

Naser Osmani, theksoi se nuk është problem përqindja 15% apo 30%, por problemi është te paradhënia 100%, siq parashihet me paragrafin 2 të nenit 12, që është një punë e rrezikshme edhe për vetë Qeverinë. Prandaj ka nevojë një sqarim se për cilat raste është menduar të jepet kjo paradhënie.

Bedri Hamza, njoftoi se paradhënia 100%, kryesisht ka të bëjë me blerjen e barnave esenciale. Ndërsa u pajtua me propozimet që të specifikohet rastet specifike.

Agim Krasniqi, njoftoi se vitin e kaluar me kontraktorët ndërkombëtar nëse nuk i ke paguar paradhënien, nuk ti ka lejuar barnat dhe si rezultat Ministria përkatëse është bllokuar. Po ashtu është edhe problemi me blerjen e çmimit më të lirë të energjisë elektrike, në rastet e caktuara.

Latif Gashi, pajtohem me mendimin e Ministrit dhe Drejtorit, se mund të specifikojmë blerjen e barnave dhe energjinë, por nuk mund ta dijmë qfarë emergjence nacionale tjetër mund të kemi. Prandaj shfaq mendimin të mbetet siq është.

Hykmete Bajrami, theksoi se nuk jemi për bllokim të situatës, nëse qoftë se e kufizojmë vetëm me barna dhe energji, mund të paraqitet ndonjë situatë tjetër emergjente, por duhet të qartësohen dhe saktësohen kushtet dhe rastet që mund të jepet paradhënia 100%. Psh. rastet kur kemi vetëm një furnizues dhe kur blerja e produktit (për barna apo energji), është në vlerën e çmimit që arsyeton paradhënien. Të mos lihet si e hapur që dikush të regjistrojë një kompani brenda natës dhe të fitojë tenderin, që lenë hapësirë për dyshime korruptive.

Naser Osmani, propozoi që të riformulohet neni 12.2, si në vijim: Qeveria mund të aprovojë pagesën e paradhënies mbi tridhjetë për qind (30%) të vlerës së kontratës me pëlqimin e Komisionit për Buxhet dhe Financa të Kuvendit të Republikës së Kosovës, për rastet specifike.

Muhamet Mustafa, është e pazakontë që të lehet mundësia e pagesës 100%, kur dihet se ekziston garancionin bankar, që mundësin kryerjen e shërbimeve të caktuar në mënyrë më të shpejtë dhe pasi që të vie malli, shikohet sasia dhe cilësia e tij dhe në fund bëhet likuidimi. Ndërkaq për rastet emergjente nacionale mund të lehet paradhënia, por mos të kufizohet vetëm në organizatat ndërkombëtare.

Bedri Hamza, u pajtua me propozimin e deputetit Osmani dhe theksoi nuk do të ishte mirë të kufizohej në rastet emergjente, sepse mund të ndodh që për shkak të çmimit më të favorshëm, një produkt të blihet në rrethanat që nuk konsiderohen emergjente (energji të blihet në pranverë).

Anëtarët u pajtuam me propozimin e Naser Osmani për riformulimin e nenit 12.2 si në vijim:

Qeveria mund të aprovojë pagesën e paradhënies mbi tridhjetë për qind (30%) të vlerës së kontratës me pëlqimin e Komisionit për Buxhet dhe Financa të Kuvendit të Republikës së Kosovës, për rastet specifike.

Kryetarja, kërkoi një sqarim për paragrafi 4 të nenit 13. Pasi që ky nen ka mbetur nga teksti i buxhetit të kaluar, dhe është i panevojshëm tani,

Të gjithë anëtarët u pajtuan që paragrafi 4 i nenit 13, të fshihet në tërësi.

Hykmete Bajrami, të neni 14.3 të shkurtimet buxhetore prej 5% për ndonjë organizatë buxhetore, siq është rasti psh. i komunave, një arsyetim nga Ministri apo drejtori, pse bëhet kjo?

Agim Krasniqi, paragrafi 3 i nenit 14 është futur vitin e kaluar, qëllimi është që tui thuhet O.B, që të ekzekutojnë buxhetin siq iu aprovohet, në të kundërtën të lihet mundësia që organizatës buxhetore që nuk ka shpenzuar buxhetin, ti merren mjetet dhe të shpenzohen aty ku ka nevojë apo paraqitet një rrethanë e papritur. Ndarja në 5% është në total të buxhetit. Sa i përket komunave nuk mund tui merret sepse kanë autonominë financiare me ligj. Qëllimi kryesorë është të krijohet një disiplinë financiare në shpenzimin e mjeteve.

Hykmete Bajrami, me vitin fiskal më të kufizuar, po i kufizojmë organizatat buxhetore në realizimin e buxhetit, sidomos në projektet kapitale, kur ndihet që po kalojnë tre muaj, pa mundësi të shpenzimit të buxhetit të tyre.

Kryetarja, kjo është nga viti i kaluar që ka pasur efekte pozitive në disiplinimin e organizatave buxhetore në shpenzimin e buxhetit të tyre.

Agim Krasniqi, neni 17 duhet të rishkruhet më ndryshe, pasi që me ndryshimin dhe plotësimin e LMFP, ka ndryshuar çështjen që është rregulluar me këtë nen. Propozimi nga Ministria do të vie nesër.

Hykmete Bajrami, nuk kemi informata shumë për kredinë ndaj ndërmarrjeve publike, dhe nuk ka informacione shtesë kur fillon dinamika dhe kushtet e kthimit, kur kemi të bëjmë me një kredi të madhe.

Naser Osmani, çështja e financimit të ndërmarrjeve publike e ka historinë që në kohën e PSSP-së kur ishte autoriteti i fundit që aprovonte buxhetin. Më pas ndërmarrjet publike janë financuar përmes buxhetit në formë të kredive, dhe kjo është më mirë që të figurojë si kredi që do të duhej të ktheheshin dhe jo të jenë në formë donacioneve.

Muhamet Mustafa, nuk është problem më i madhë dhënia e kredive ndërmarrjeve publike, sa është problem efekti i shfrytëzimit të destinimit të këtyre mjeteve. Me këtë ligj do të duhej sanksionohet obligimi i raportimit për këto mjete te Ministria e Financave dhe auditimit për shfrytëzimin e këtyre mjeteve.

Sali Asllanaj, theksoi se është kundër kreditimit të ndërmarrjeve publike dhe kthimi i kredive është fiktive dhe ka kuptimin zhvleftësimin e atyre ndërmarrjeve. Psh. në rast të interesimit të privatizimit të KEK-ut, për shkak të borqeve që ka kjo ndërmarrje, do të ndikonte në zhvlerësimin e ofertës së ofertuesit.

Bedri Hamza, njoftoi se kreditë nuk të bëjnë me pjesën operacionale të KEK-ut, por me hapjen e minierave të reja dhe blerjen e ekskavatorëve. Kthimit duhet të ndodhë sipas kontratave ekzistuese. Ky do të jetë viti i fundit të kreditimit të KEK-ut dhe parashikimi është që kthimi i kredive të fillojë nga viti 2013. Kreditimi ka qenë nevojë e domosdoshme, për shkak të nevojës për furnizim me energji të termoelektranave.

Kryetarja, u propozua që neni 19 riformulohet si në vijim: Ky ligj hyn në fuqi me 1 prill 2011. Propozimi u përkrah unanimisht.

3. Shqyrtimi i rekomandimeve të komisioneve parlamentare lidhur me Projektligjin e Buxhetit të Republikës së Kosovës për vitin 2011:

3.1. Shqyrtimi i rekomandimit të Komisionit për Mbikëqyerjen e Financave Publike dhe kërkesë buxhetor të Zyrës së Auditorit të Përgjithshëm

Kryetarja, theksoi se komisioni përkatës ka rekomanduar që të miratohet kërkesa e Zyrës së Auditorit të Përgjithshëm. ZAP kërkon rritjen e numrit të punëtorëve si dhe ndarjen e buxhetit shtesë për pagat e këtyre punëtorëve, si dhe rritje buxhetit për të mallrave dhe shërbimeve.

Sali Asllanaj, jam kundër rritje së numrit të punëtorëve. Nëse është marrëveshje për rritjen e auditorëve për 20% qdo vit, atëherë do të kemi rritje të pakufizuar.

Naser Osmani, mbështeti propozimin për rritjen e auditorëve për 8 pozita dhe ata të jenë auditor dhe ndarjen e buxhetit për këta auditor.

Pas diskutimeve dhe propozimeve, Komisioni njëzëri nxori këtë:

PËRFUNDIM

- Lejohen rritje e numrit të auditorëve shtesë për 8 pozita dhe ndarje e mjeteve në kategorinë paga dhe mëditje për këta punëtorë. Ndërsa 16.000€ të mjeteve e mjeteve të planifikuara për shpenzimet komunale, barten në kategorinë mallra dhe shërbime.

3.2. Shqyrtimi i rekomandimit të Komisionit për Punë të Jashtme për rritjen e buxhetit për Ministrinë e Punëve të Jashtme

Kryetarja, rekomandimi i komisionit jo konkret

Bedri Hamza, kemi pasur takime me Ministrinë përkatëse ku sipas kërkesës për mallra dhe shërbime, kemi rritur buxhetin e tyre, ndërsa të investimeve kapitale, kanë kërkuar që blerja e ambasadave, të hiqe me përjashtim të ambasadës në Bruksel janë tërhequr.

Pas diskutimeve dhe propozimeve, Komisioni njëzëri nxori këtë:

PËRFUNDIM

Buxheti i Ministrisë së Punëve të Jashtme mbetet në kufijtë e planifikuar dhe miratuar në Projektligjin për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2010.

3.3. Shqyrtimi i rekomandimit të Komisionit për Bujqësi, Pylltari, Zhvillim Rural, Mjedis dhe Planifikim Hapësinor për rritjen e buxhetit për Ministrinë e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural

Kryetarja, konstatoi se pasi që nuk kemi ndonjë propozim konkret nga komisioni përkatës, Komisioni njëzëri nxori këtë:

PËRFUNDIM

Buxheti i Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural mbetet në kufijtë e planifikuar dhe miratuar në Projektligjin për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2010.

3.4. Shqyrtimi i rekomandimit të Komisionit për Shëndetësi, Punë dhe Mirëqenie Sociale për rritjen e buxhetit për Ministrinë e Shëndetësisë

Kryetarja, nuk kemi ndonjë propozim konkret nga komisioni përkatës

Bedri Hamza, Ministria përkatëse ka pasur një kërkesë që kërkon harmonizime të brendshme në investime kapitale. Kërkojë nga komisioni, nëse ajo vie me shkrim të merret në konsideratë.

Pas diskutimeve, Komisioni njëzëri nxori këtë:

PËRFUNDIM

Buxheti i Ministrisë së Shëndetësisë mbetet në kufijtë e planifikuar dhe miratuar në Projektligjin për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2010.

4. Shqyrtimi i kërkesave buxhetore lidhur me Projektligjin

4.1. Shqyrtimi i kërkesës së Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës për buxhet shtesë dhe nivelizim të pagave

Kryetarja, njoftoi se kërkesa ka të bëjë me rritjen e pagave të anëtarëve të Këshillit, si rezultat i ndryshimit të legjislacionit. Më legjislacionin e kaluar paga e tyre është paraparë të jetë në nivelin e gjyqtarëve të gjykatës supreme. Me ligjin e ri parashihet që paga e tyre të rregullohet me ligjin për pagat e zyrtarëve të lartë publik, i cili ligj nuk ekziston. Duke ditur se ligji i ri për gjykatat parasheh që pagat e gjykatësve të rriten, kërkesa e këtij Këshilli është që të kenë pagat ekuivalente me të gjyqtarëve të gjykatës supreme. Mirëpo me qenë se ligji i ri nuk referohet në pagën e gjyqtarëve, propozojë që këtyre anëtarëve t'u rritet paga 30% mbi pagën bazë aktuale që e kanë.

Sali Asllanaj, pasi që anëtarët e Këshillit nuk janë shërbyes civil, nuk duhet që rritja e pagave të jetë 30%, sepse do të trajtoheshin si shërbyes civil, në aspektin e rritjes së pagave.

Hykmete Bajrami, pasi që kemi disa kërkesa të kësaj natyre, u pajtua që në mungesë të bazës ligjore, përkohësisht, të gjindet një zgjidhje për rritjen e pagave të këtyre zyrtarëve, deri sa të miratohet Ligji për pagat e zyrtarëve të lartë publik.

Latif Gashi, nuk do të ishte mirë që të refuzohet kërkesa, pasi që kemi të bëjmë me shuma të vogla të rritjes, kur dihet se ekziston një vendim për rritje të pagave. Kërkojë një mendim të Ministrisë për këtë qëllim?

Bedri Hamza, në përgjigjen e parafolësit theksoi se ne respektojmë vendimet e Komisionit dhe rritjet eventuale, do të plotësohen nga shkurtimet që do të bëhen brenda buxhetit të propozuar nga Qeveria.

Pas diskutimeve dhe propozimeve, Komisioni njëzëri nxori këtë:

PËRFUNDIM

Rekomandohet rritja e pagës 30% mbi pagën bazë për kryesuesin dhe anëtarët e Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës. Rekomandimi do të pasqyrohet në formë të amendamentit në raportin e Komisionit drejtuar Kuvendit për miratim.

4.2. Shqyrtimi i kërkesës së Komisionit të Pavarur për Miniera dhe Minerale

Kryetarja, kërkesa e KPMM-së ishte të rritet buxheti për nëntë punëtor. Por edhe për 71 punëtorët aktual, nga takimet që kam zhvilluar, kanë thënë se kanë mungesë të buxhetit për 27.000€.

Pas diskutimeve dhe propozimeve, Komisioni njëzëri nxori këtë:

PËRFUNDIM

- Përkrahet kërkesa e KPMM-së për shtimin e buxhetit për 27.000€, në kategorinë paga dhe mëditje. Rekomandimi do të pasqyrohet në formë të amendamentit në raportin e Komisionit drejtuar Kuvendit për miratim.

4.3. Shqyrtimi i kërkesës së Institucionit të Avokatit të Popullit

Kryetarja, njoftoi se kërkesa e Avokatit të Popullit është në shpërpushje të madhe nga buxheti i propozuar nga Qeveria. Pas bisedës që kam pasur me përfaqësuesin e Avokatit të Popullit, jam informuar se ky institucion fare nuk e ka dorëzuar kërkesën në Ministri, por direkt në Kuvend. Përveç kërkesave shtesë për punëtor dhe kategoritë të tjera, është një kërkesa për shtimin e një zëvendës avokati siq e parasheh ligji. Po ashtu kërkesa e këtij institucioni është që avokatit të popullit dhe pesë zëvendësve të tij ti rritet rroga ekuivalent me gjyqtarët e gjykatës supreme, pasi që me legjislacionin e vjetër e kanë pasur të nivelit të njëjtët, ndërkaq sikurse me Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës, parashihet që pagat e avokatit dhe zëvendësve të tij, të rregullohen me ligjin për pagat e zyrtarëve të lartë, i cili ligj nuk ekziston. Propozojë që për avokatin dhe pesë zëvendësit e tyre tiu rritet paga 30% mbi pagën bazë që e kanë. Ndërkaq kërkesa shtesë e tyre është edhe për ndarjen e mjeteve për qira.

Bedri Hamza, mbështeti propozimin për ndarjen e mjeteve për qira, por kërkojë të jenë të specifikuara vetëm për atë qëllim.

Pas diskutimeve dhe propozimeve, Komisioni njëzëri nxori këtë:

PËRFUNDIM

Përkrahet kërkesa e Institucionit të Avokatit të Popullit, shtimin një zëvendësve të avokatit të popullit, siq e parasheh ligji, si dhe rritja e pagave 30% mbi pagën bazë për avokatin e popullit dhe pesë zëvendësit e tij. Ndërkaq të bëhet shkurtimi i në kategorinë shpenzime komunale në vlerë prej 10.000€ si dhe shtimi i buxhetit për mallra dhe shërbime. Rekomandimi do të pasqyrohet në formë të amendamentit në raportin e Komisionit drejtuar Kuvendit për miratim

4.4. Shqyrtimi i kërkesës së Komisionit të Pavarur për Media

Kryetarja, njoftoi se pagat e zyrtarëve të këtij komisioni krahasuar me vitin e kaluar janë zvogëluar. Propozoj që pagat dhe mëditje, si dhe mallrat dhe shërbimet të mbeten si vitin e kaluar.

Pas propozimit, Komisioni njëzëri nxori këtë:

PËRFUNDIM

- Përkrahet kërkesa për shtimin e buxhetit shtesë në kategorinë mallra dhe shërbime. Rekomandimi do të pasqyrohet në formë të amendamentit në raportin e Komisionit drejtuar Kuvendit për miratim

4.5. Shqyrtimi i kërkesës së Këshillit Gjyqësor të Kosovës për ndryshimin projekteve kapitale

Kryetarja, njoftoi se kërkesa është për rregullime të brendshme në kategorinë investime kapitale.

Agim Krasniqi, propozoi që për shkak të rregullatives së caktuar, KGJK të rregullojë kërkesën në MF, pastaj në formë të propozimit do ti sjelljet komisionit.

Pas propozimeve, Komisioni njëzëri nxori këtë:

PËRFUNDIM

Përkrahet kërkesa e KGJK-së për ndryshimin e projekteve kapitale, e cila do të prezantohen në amendamentet e Komisionit drejtuar Kuvendit për miratim.

4.6. Shqyrtimi i kërkesës së Agjencionit Kosovar të Pronës

Kryetarja, kërkesa është që caktimin e pagave për dy anëtarët e bordit mbikëqyrës të AKP-së, të cilët nuk kanë paga që nga koha që janë zgjedhur nga Kuvendi. Propozojë që tui caktohet një pagë prej 500€ në muaj për vitin 2011.

Pas propozimit, Komisioni njëzëri nxori këtë:

PËRFUNDIM

Miratohet kërkesa për caktimin e pagave për dy anëtarët e bordit mbikëqyrës të AKP-së në vlerë prej 500€ në muaj, për vitin 2011.

4.7. Shqyrtimi i kërkesës së Institutit Gjyqësor të Kosovës

Agim Krasniqi, theksoi se kërkesa e tyre është të trajtohen me shërbyesit civil. Ne kemi thënë nëse vitet e kaluar janë trajtuar më mirë se shërbyesit civil, nuk kemi mundur tui caktojmë pagat në emër të rritjes që janë bërë për shërbyesit civil. Sa i përket mëditjeve për trajnime janë të caktuar 300€, që është paga mesatare në Kosovë. Buxheti në mallrat dhe shërbimet është mbetur në nivelin e shpenzimeve që kanë bërë vitin e kaluar.

Naser Osmani, theksoi se ata që kanë dalë prej statusit të shërbyesve civil për shkak të pagave më të larta, nuk mund tui rriten pagat. Nëse iu rrisim pagat atëherë duhet ti kthejmë në sistem të shërbyesve civil. Propozojë që të mbetet buxheti si është.

Xhevdet Neziraj, njoftoi se nga vizitat studimore që kemi realizuar në Gjermani, nga diskutimet që kemi zhvilluar, kemi mësuar që me rekomandimet e auditorit për mosshpenzimit e buxhetit të agjencive buxhetore, vitin tjetër këtyre agjencioneve dhe institucione iu shkurtonte buxhetin në nivelin e shpenzimit që kanë pasur vitin e kaluar. Kjo është një praktikë e mirë që do duhej të aplikohet edhe tek ne.

Kryetarja, konstatoi se për shkak të mungesës së arsyeshmërisë së kërkesës, nuk aprovohen kërkesa të IGJK-së, por në rast të ndonjë nevojë të veçantë, ne si Kuvend në të ardhmen do të trajtojmë kërkesat e këtij organi të pavarur.

Pas diskutimeve dhe propozimeve, Komisioni njëzëri nxori këtë:

PËRFUNDIM

Buxheti i IGJK-së mbetet si është propozuar nga Qeveria, në projektligjin për Buxhetin 2011.

4.8. Shqyrtimi i kërkesës së Komisionit të Qendror të Zgjedhjeve për rritjen e numrit të punëtorëve për tre pozita dhe koston financiare për implementimin e Ligjit për Financimin e Subjekteve Politike dhe Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës

Kryetarja, kërkesa është për shtimin e tre pozitave dhe pagat për ata për të menaxhuar fondin e partive politike.

Agim Krasniqi, i kanë të gjitha strukturat, do të jetë vështirë të shtohet rritja e numrit të punëtorëve.

Pas diskutimeve dhe propozimeve, Komisioni njëzëri nxori këtë:

PËRFUNDIM

Nuk përkrahet kërkesa e KQZ-së për rritjen e numrit të punëtorëve dhe koston financiare për tre pozita.

4.9. Shqyrtimi i kërkesës së Koalicionit : Sindikatave të Pavarura të Pensionistëve, Organizata e Invalidëve të Punës në Kosovë dhe Partia e Pensionistëve të Kosovës

Kryetarja, njoftoi se kërkesa e koalicionit të pensionistëve është për rritjen e pensioneve 60€ në nivelin e pagave të shërbyesve civil. Pasi që jemi në pritje të projektligjit për pensionet, të cili iu është bërë kostoja nga Qeveria. E vetmja mundësi është që të presim projektligjin për tu marrë me këtë punë.

Naser Osmani, theksoi se pensionet meritojnë t'u rritet rroga 50%, por për këtë çështje nuk mundet të diskutojmë tani. Kur vjen projektligji do ta kemi për diskutim. Si opozitë do të kërkojë 50% rritje të pagave, sikurse punëtorëve të arsimit. Sugjeroi që me rastin e hartimit të raportit me amendamente, Kryetarja në emër të komisionit, të rekomandojë që në rast të vonesës së miratimit të ligjit, Qeveria të nxjerr një vendim, që kësaj kategorie, të paktën të iu shtohet mjetet e planifikuar.

Agim Krasniqi, njoftoi se në një draft që është përgatit më herët është vlerësuar kostoja në kategoritë e caktuar dhe pensioni me u rrit në shkallë të ndryshme, 20€ për kategorinë e parë ndërsa 5 € për ata që i kanë 45€, por qfarë do të dal prej projektligjit nuk e dijmë. Kjo është pjesë e marrëveshjes me FMN.

Muhamet Mustafa, për shkak se disa kategori të pensionistëve gjinden në një pozitë të rëndë sociale, kjo kërkon një trajtim më serioz. Ndërsa në ligjin e ri do të duhej një trajtim i veçantë dhe i diferencuar për pensionistët.

Sali Asllanaj, theksoi se edhe në seancë plenare e ka ngritur këtë çështje. Kjo kategori është në gjendje të mjerueshme dhe meriton të trajtohet me më humanitet, sepse në këtë gjendje qfarë janë dhe të diskriminuar. Prandaj me ligjin e ri dhe më së voni vitin e ardhshëm, të merremi më seriozisht me këtë kategori. Por njëkohësisht të punohet në pastrimin e listave të përfituesve që janë bërë abuzime në ndihmat sociale, kjo do të ndihmonte dhënien e pensioneve meritore atyre që e meritojnë.

Pas diskutimeve dhe propozimeve, Komisioni njëzëri nxori këtë:

PËRFUNDIM

- Çështja e rritjes së pensioneve do të diskutohet, me rastin e shqyrtimit dhe amendamentimit të projektligji për pensionet.

4.10. Shqyrtimi i kërkesës së N.P. Termokos për dyfishimin e subvencioneve të lëndës djegëse Mazut

Kryetarja, kërkesa është të dyfishohen subvencionet për blerjen e lëndës djegës - Mazut. Pasi që qeveria ka paraparë subvencione dhe nuk është nevoja për shtimin e tyre. Sugjerimi do të ishte që kjo ndërmarrje publike të mbledh borqet e konsumatorëve që i kanë ndaj kësaj ndërmarrje publike

Pas diskutimeve dhe propozimeve, Komisioni njëzëri nxori këtë:

PËRFUNDIM

Nuk përkrahet kërkesa e N.P. Termokos për dyfishimin e subvencioneve të lëndës djegëse Mazut

5. Të ndryshme

Në këtë pikë u diskutua për disa kërkesa të Ministrive për ndarjen e buxhetit shtesë në kategoritë e caktuara.

Agim Krasniqi, njoftoi anëtarët se me rastin e përcaktimit të kufijve buxhetor, kemi kërkuar nga të gjitha ministratë, të përfshihen obligimet nga marrëveshjet dhe kontratat ndërkombëtare, për realizimin projekteve të caktuara, por një pjesë e tyre nuk i kanë përfshirë.

Hasime Krasniqi, sa i përket kërkesave të ministrive, shfaqti mendimin që në këtë afat të shkurtër të mos trajtohen, që pasi që buxheti i tyre tanimë është aprovuar në Qeveri. Ndërkaq propozoi që para shqyrtimit të secilës kërkesë dhe marrjes së vendimit nga komisioni, të merret mendimi i ministrisë për mundësinë e mbulimeve buxhetore, të këtyre kërkesave të propozuara.

Mbledhja përfundoi në orën 13:20

Përgatitur nga:

Njësia për mbështetjen e Komisionit

Kryetarja e Komisionit

Safete HADERGJONAJ